



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.202/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINE- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë, në konfliktin administrativ-komercial sipas padisë së paditësit, Nderimi shpk nga Ferizaj i përfaqësuar nga K.B avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë e përfaqësuar nga K.K me autorizim, me bazë juridike, vlersim doganor, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.692/2017 të datës 07.11.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.09.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.692/2017 datës 07.11.2019, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Nderimi shpk nga Ferizaj, është anuluar Aktvendimi nr.06.2/55 dt.20.03.2017 i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe është obliguar e paditura që paditësit t,ia kthej shumën prej 915.00€ të paguar më tepër në emër të detyrimeve importuese doganore për mallin e importuar përmes Deklaratës Doganore R257 dt.10.01.2017 ZBD Prizren. Shpenzimet e procedurës i bart secila palë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ushtron e paditura, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të; shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, të prishet aktgjykimi A.nr.692/17 dt.07.11.2019 si i pabazuar në ligj. Aktgjykimi përmban shkelje të nenit 34 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Në bazë të analizimit të dokumenteve unike doganore të deklaruara shihet se paditësi ka deklaruar mallin në fjalë me çmime më ulta dhe se Dogana e Kosovës ka disponuar me të dhëna për mallin në fjalë me çmime më të larta se ai i deklaruar. Interpretimi i gjykatës është i gabuar dhe jo i bazuar në dispozita ligjore. Konstatimi se subjekti deklaratës doganore i ka bashkangjitur faturën dhe transaksionin bankar dhe se me këto janë të mjaftueshëm që të aprovohet padia dhe të vlersohet malli siaps metodës së parë është konkluzion i gabuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222 dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e organit të paditur Dogana e Kosovës në Prishtinë nr.06.2/55 të dt.20.03.2017, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë Nderimi shpk nga Ferizaj, për rishqyrtimin e vendimit R-257/10.01.2017 të ZBD Prizren, si të pabazuar. Në arsyetim të vendimit administrativ theksohet se Zyra e Inspektimit pas zhdoganimit ka vepruar drejt kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor. Vlersimi i mallit lëndor është bërë me ndryshimin e metodës së vlersimit ashtu që në rastin konkret është aplikuar metoda e 3 e vlersimit neni 34 par.2 pika (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109 respektivsiht në bazë të vlerës së transaksioneve të mallrave të ngjashme të zhdoganuara në periudh të afërt kohore, si provë paraqet DUD-at e verifikuar në sistemin Cognos dhe Asycuda, si importe identike dhe të ngjashme të mallrave por me vlerë më të lartë se sa vlera e mallit kontestues (R-606/17.01.2017, R-609/17.01.2017, R-613/17.01.2017).

I pakënaqur me aktvendimin e te paditurit, subjekti ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ-komercial në Gjykatë të shkallës së parë, e cila në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesor me dt.07.11.2019, dhe pas administrimit të provave për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, e anulon aktvendimin kontestues të organit të paditur, dhe e obligon te padituren qe paditësit t,ia kthej shumën prej 915.00€ të paguar më tepër në emër të detyrimeve importuese doganore për mallin e importuar përmes Deklaratës Doganore R257 dt.10.01.2017 ZBD Prizren. Shpenzimet e procedures i bart secila palë. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar vendimin duke u referuar në nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave e cila dispozit paarsheh se “Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin e vërtet të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë” dhe dispozitat e nenit 123 par.1 pika (a) të U.A. nr.11/2009. Paditësi ka paraqitur faturat dhe transaksionin bankar me të cilin dëshmohet qmimi i paguar i mallit me qëllim eksporti në Kosovë siq kërkohet me nenin 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje të dispozitave procedurale, Kolegji i Dhomës së Dytë, nuk i aprovoi, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, kjo për faktin se paditësi ka deklaruar mallin me çmim më të ultë dhe se Dogana e Kosovës ka disponuar me të dhëna me çmime më të larta se ai i deklaruar, këto pretendime ankimore Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë nuk i aprovoi, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë rast provat-të dhënat e disponueshme të prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative-komerciale. Ngase gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se paditësja në procedurën administrative-komerciale tek e paditura, por edhe në këtë konflikt administrativ ka paraqitur dokumentacionin valid dhe të mjaftueshëm si provë për DUD-in me nr R-257 dt.10.01.2017 të ZBD Prizren, faturat e mallit, deklaratën eskportuese dt.05.01.2017, kontratën e shitblerjes dt.04.01.2017, urdhërpagesën bankare dt.20.01.2017 me të cilat dokumentacione është paguar vlera e mallit të kontraktuar dhe të gjitha këto dokumentacione rezultojnë të jenë të harmonizuara sai përket vlerës së mallit të importuar në kuptim të nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109.

Prandaj, pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje të dispozitave ligjore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë pa bazuar dhe pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, Aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Andaj, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji material në dëm të paditurës. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.202/2022 datë 06.09.2022

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari,

Krenar Berisha